

Vendim nr. 123 datë 08.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 08.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (M) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: MARGARITA GURALUMI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1853, datë 13.10.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 175, datë 15.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; nr. 2040, datë 30.09.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2022-1864, datë 08.09.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, pika 2, 41, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, pika 1 dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Margarita Guralumi i ka kërkuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Krujë (KKKP) njohjen e së drejtës së pronësisë të të ndjerit P.M.,

kërkesë e cila është rrëzuar nga ky komision me vendimin nr. 179, datë 02.11.1997 (*vendimi nr. 179/1997*). Në vijim ajo i ka kërkuar Komitetit Shtetëror të Kthimit e Kompensimit të Pronave të rishikojë vendimin nr. 179/1997 të KKKP-së, Krujë, për të cilën ka marrë përgjigje se problemi për pronësinë e pretenduar është zgjidhur me vendimin nr. 341, datë 26.12.1997 (*vendimi nr. 341/1997*) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe, për sa i përket pretendimit për regjistrimin e pronës nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Krujë (ZVRPP), duhet t'i drejtohet gjykatës.

2. Kërkuesja i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke kërkuar pajisjen me certifikatë pronësie për pasuritë e disponuara sipas vendimit nr. 341/1997 të asaj gjykate, e cila, me vendimin nr. 544, datë 02.10.2009, ka vendosur pranimin e padisë së kërkueses, duke e detyruar ZVRPP-në, Krujë ta pajisë atë me certifikatën e pronësisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim ZVRPP-ja, Krujë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1853, datë 13.10.2010, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 544, datë 02.10.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, pas rigjykimit të çështjes, me vendimin nr. 175, datë 15.04.2013, ka vendosur "*Rrëzimin e padisë*", pasi një pjesë e mirë e pasurive të pretenduara nga kërkuesja figurojnë të regjistruara në emër të personave të tjerë dhe aktet përkatëse të fitimit të pronësisë ajo ka të drejtë që t'i kundërshtojë me padi themeli.

5. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kërkuesja ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 1820, datë 02.05.2014, ka vendosur të shpallë moskompetencën lëndore për gjykimin e çështjes, duke i dërguar aktet në Gjykatën Administrative të Apelit, si gjykata kompetente. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2040, datë 30.09.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 175, datë 15.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Kundër këtij vendimi, në datën 16.11.2015, kërkuesja ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-1864, datë 08.09.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar.

7. Në datën 24.04.2023 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të kërkesës, i cili është plotësuar në datën 08.05.2023.

II

Pretendimet e kërkuases

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se vendimet objekt kërkesë i kanë cenuar:

8.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

8.1.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykatat në vendimet objekt kërkesë nuk kanë marrë parasysh se vendimi nr. 341/1997 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për njohjen e së drejtës së pronës së kërkuases (në bashkëpronësi), për një tokë me sipërfaqe 17.400 m², është i formës së prerë dhe tashmë i ekzekutuar nga ZVRPP-ja, Krujë, e cila për këtë ka lëshuar edhe vërtetimin nga dokumenti hipotekor nr. 223, datë 05.10.2000. Po kështu, e drejta e pronësisë së saj nuk rrjedh nga një vendim gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik, por nga nota e transkriptimit nr. 226/242 të vitit 1935, në bazë të së cilës është bërë e mundur regjistrimi i vendimit nr. 341/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

8.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk përmban interpretimin dhe analizën juridiko-ligjore të konfliktit në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuar për pretendimet e kërkuases.

8.1.3. *Barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat nuk janë shprehur dhe as kanë mbajtur qëndrim për shkeljet e kryera nga ZVRPP-ja, Krujë, e cila, në atë proces, nuk i ka paraqitur dokumentet që dispononte, ndonëse janë kërkuar nga kërkuessa edhe gjatë gjykimit, pasi, përmes tyre, provohen mosveprimet e atij institucioni dhe dëmi i pariparueshëm që ka pësuar ajo.

8.2. *Të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi gjykatat e të tria shkallëve ia kanë mohuar tërësisht atë për një pronë të fituar me një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi (*neni 193, paragrafi i parë, shkronja “dh”, i Kodit Civil*), si dhe mbi bazën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuases*

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person

fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

10. Si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuuesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, kërkuuesja kundërshton vendimin nr. 00-2022-1864, datë 08.09.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit të saj. Në këtë kuptim, në lidhje me të drejtat që pretendon se i janë shkelur, Kolegji vlerëson se kërkuuesja e plotëson kriterin për shterimin e mjeteve juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohet Gjykatës.

13. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

14. Kolegji vëren se kërkuuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 24.04.2023 për të kundërshtuar vendimin e datës 08.09.2022 të Gjykatës

së Lartë, pra dukshëm jashtë afatit ligjor 4-mujor. Kërkuesja, për sa i përket legjitimitetit të saj, ka pretenduar se i ka plotësuar të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, përfshirë edhe kriterin e afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual të parashikuar në pikën 1, shkronja “b”, të po këtij neni. Ajo ka parashtruar se në datën 25.01.2023 ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesën për informacion në lidhje me çështjen e saj. Për këtë kërkesë kancelari i Gjykatës së Lartë i ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 604/1 prot., datë 31.01.2023, duke e informuar kërkuesen se çështja administrative nr. 31003-02489-00-2015, datë 11.12.2015, ka përfunduar me vendimin nr. 00-2022-1864, datë 08.09.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me të cilën ka bashkëlidhur edhe një kopje të vendimit në fjalë, të nxjerrë nga faqja zyrtare e asaj gjykate. Kërkuesja ka deklaruar se këtë shkresë e ka marrë përmes shërbimit postar në datën 02.02.2023.

15. Gjithashtu, sipas përgjigjes së kancelarit të Gjykatës së Lartë, me shkresën nr. 277/1 prot., datë 19.05.2023, për informacionin e kërkuar nga Gjykata, me shkresën nr. 479 prot., datë 16.05.2023, rezulton se vendimi objekt kundërshtimi është bërë i disponueshëm për palët në datën 24.10.2022 dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit të asaj gjykate po në datën 24.10.2022.

16. Kolegji konstaton se ka qenë kërkuesja që ka bërë rekurs, pra ka pasur dijeni për çështjen e saj dhe është interesuar në Gjykatën e Lartë për fatin e asaj çështjeje. Referuar faqes zyrtare të asaj gjykate, rezulton se në datën 29.07.2022 është bërë shpallja e çështjes së kërkueses, duke përcaktuar datën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues. Pas shqyrtimit të çështjes në datën e caktuar (08.09.2022), po në atë datë është publikuar edhe dispozitivi i vendimit për çështjen e kërkueses, ndërsa vendimi i plotë është publikuar në datën 24.10.2022.

17. Në raste të ngjashme Kolegjet e Gjykatës kanë vlerësuar se paraqitja e shkresës së gjykatave, ku kërkuesit janë pajisur me një kopje të vendimit të Gjykatës së Lartë, nuk provon datën e marrjes dijeni efektivisht për atë vendim, sepse një shkresë e tillë mund t’i drejtohet individit në çdo kohë nga ajo gjykatë (*shih vendimet nr. 116, datë 08.10.2021; nr. 126, datë 29.10.2021; nr. 36, datë 21.01.2020 të Kolegjeve të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, kërkuesja i është drejtuar me shkresë Gjykatës së Lartë në datën 24.04.2023, por nuk ka dhënë ndonjë arsye se përse nuk ka qenë e mundur që t’i drejtohej më përpara. Për sa i përket alternativës tjetër të njoftimit, atij individual nëpërmjet postës elektronike, sipas nenit 482, pika 3, të Kodit të Procedurës Civile, i zbatueshëm për gjykimin administrativ dhe urdhrit nr. 131, datë 02.07.2021 “Për publikimin e datave të gjykrimeve dhe njoftimin e palëve” të nxjerrë nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, një gjë e tillë nuk duket se gjen zbatim në rastin e kërkueses, pasi nga ajo nuk pretendohet të jenë lënë të dhënat e saj elektronike të kontaktit.

19. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë kërkesa nuk përmbush kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.